



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 123 prot.

Kamëz, më 23.09 .2024

V E N D I M
Nr. 93 .Datë 23/09 2024
M B I

“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA
BUXHETI I BASHKISË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.09.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.71 Datë 19.09.2024, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, ligji nr.57 dt. 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, të Vendimit nr. 597 datë. 04/09/2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB nr.103 dt 18.12.2023 “ Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026; VKB nr. 6 datë 22.01.2024 mbi: “Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë për vitin”, 2024, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike për **87** familje me një fond prej **727,000 (shtatëqind e njëzetë e shtatë mijë)** lekë për muajin **Shtator 2024**. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Ky vendim hy në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

